



Zyra e Shtypit
20 janar 2010

MBI NDËRHYRJET NË TREGUN E PARASË DHE NË TREGUN VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË VITIT 2009

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhryrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektimin e likuiditetit.

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë*)

DATA	R/REPO njëjavore me çmim fiks	R/REPO mujore	R/REPO tremujore
02.07.2009	20,680.00		
09.07.2009	16,620.00		
16.07.2009	17,830.00		
23.07.2009	20,010.00		
30.07.2009	25,190.00		3,500.00
06.08.2009	29,280.00		3,000.00
13.08.2009	32,380.00		
20.08.2009	34,170.00		
27.08.2009	27,590.00	3,000.00	
03.09.2009	18,160.00	3,400.00	
10.09.2009	17,940.00	2,950.00	
17.09.2009	19,760.00	4,320.00	
24.09.2009	19,760.00	3,000.00	

Për të injektuar likuiditet, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor *marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor*, mesatarisht 23.03 miliardë lekë* në javë si dhe instrumentet rregullues me maturim më të gjatë se një javë - *marrëveshjen e riblerjes me maturim 1 dhe 3-mujor*. *Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim njëmujor* u përdor në 5 raste, mesatarisht 3.33 miliardë lekë për ankand). Ndërsa *marrëveshja e anasjelltë tremujore* u përdor në dy raste, mesatarisht 3.25 miliardë lekë për ankand.*

* Shifrat janë në vlerë nominale.


1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2009, depozita njëditore u përdor mesatarisht 0.35 miliardë lekë në ditë në krahasim me 0.14 miliardë lekë në ditë gjatë tremujorit të kaluar. Përdorimi i depozitës njëditore ishte më intensiv gjatë ditëve të fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës të detyruar.

Instrumenti i kredisë njëditore gjeti një përdorim minimal gjatë këtij tremujori (një rast përdorimi në nivelin 5.7 milionë lekë).

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2009.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2009 (me çmim blerjeje)



2. NDËRHYRJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në tremujorin e tretë të vitit 2009, Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor.

Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Shitjet me Ministrinë e Financave gjatë tremujorit të tretë llogariten në 0.2 miliardë lekë. Vëllimi i blerjeve me Ministrinë e Financave për këtë periudhë ka qenë 4.6 miliardë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 64.00 milionë lekë.

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE	4,557.00	201.00
TË TJERA (IDA, IBRD)	64.00	